



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 03-03/OPK Nr. Prot. 01-1665/16
Bt. Prot. 01-1665/16
Data 03.05.2016
Broj stranica 05
Nr. pages 05
PUSHKINE

DATE/A:	29.04.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP 03-03/133916
PËR/ZA/TO:	z. Nuro ISMAILI , Menaxher i zyrës së Prokurimit në Komunën e Dragashit
CC:	z. Salim JENUZI , Kryetar i Komunës së Dragashit,
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Kubëzimi i rrugëve në fshatin Leshtanë – K.K. Dragash "

I nderuari z. Ismaili ,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin " Kubëzimi i rrugëve në fshatin Leshtanë – K.K. Dragash " me numër të prokurimit: 621-2016-019-536, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin " **Kubëzimi i rrugëve në fshatin Leshtanë – K.K. Dragash** " me numër të prokurimit: 621-2016-019-536, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të ligjit nr. 05/l -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-237.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit në tekstin e mëtejme Agjencia me datë 05.04.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokoll *AKK-03-03-1339/16* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "**Kubëzimi i rrugëve në fshatin Leshtan – K.K. Dragash**" me numër të prokurimit: **621-2016-019-536**, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Dragashit. Agjencia me datë 05.04.2016 dhe datë 12.04.2016 ka paraqitur kërkesat për dokumentacion, ku ka kërkuar nga Autoriteti kontraktues t'a dorëzojë në Agjenci tërë dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit, para se A.K. të bëjë njoftimin për dhënie të kontratës.

Agjencia pasi ka bërë kontrollimin e njoftimeve të publikuara në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ për prokurimin publik ka vërejtur se me datë 21.04.2016, Autoriteti kontraktues ka bërë dhënien e kontratës e cila është publikuar në faqe KRPP-së. Duke vepruar në mënyrë të njëanshme Autoriteti kontraktues nuk e ka përfillur kërkesën e Agjencisë e cila ka kërkuar që të mos bëhet dhënia e kontratës, para se Agjencia t'a trajtojë dokumentacionin për këtë aktivitet të prokurimit.

Shkeljet ligjore gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka analizuar me kujdes dosjen e tenderit, konstaton se autoriteti kontraktues ka paraparë kontratë për punë ndërtimore të cilën e ka zhvilluar në procedurë të kuotimit të çmimeve, veprim ky i cili është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik. Agjencia konsideron se autoriteti kontraktues nuk ka zgjedhur procedurën e duhur për realizimin e punëve për këtë projekt. Agjencia gjithashtu vëren se ky aktivitet ka të bëjë me kubëzim të rrugëve ku vlera e parashikuar e kontratës është afër limitit i cili e ndanë procedurën e kuotimit të çmimeve me procedurën e hapur. Më saktësisht Autoriteti kontraktues në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka paraparë vlerën e parashikuar të kontratës në vlerë prej **9,999.00 €**, ndërsa në kërkesën e njësisë kërkuese dhe deklaratën e nevojave dhe disponueshmërinë e mjeteve ka paraparë vlerën prej **10,000.00 €**. Në këtë rast Autoriteti kontraktues do të duhej të përcaktohej për procedurën e hapur, pasi që edhe vlera e parashikuar e kontratës është e mesme.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka analizuar me kujdes dosjen e tenderit vëren gjithashtu se dosja standarde e aprovuar nga KRPP për kontratë të punëve, për këtë aktivitet të prokurimit është modifikuar në kundërshtim me ligjin. Nëse analizojmë listën e çmimeve pikën 2 të kësaj dosje të tenderit, vërejmë se Autoriteti ka kërkuar nga Operatorët ekonomik t'a japin çmimin vetëm për njësi pa total të përgjithshëm të tenderit. Në listën e çmimeve ka përkshkruar 8 pozicione, njësinë matëse, çmimin e tenderit në shifra dhe në fjalë duke mos përkshkruar sasinë, totalin e përgjithshëm për secilin pozicion dhe totalin e përgjithshëm të të gjitha pozicioneve. Nuk ka përputhje në mes

listës së çmimeve nga dosja e çertifikuar në KRPP dhe listës së çmimeve në dosjen e cila i 'u është shpërndarë ofertuesve konkurrues.

Ligji në fuqi i prokurimit publik në Republikën e Kosovës nuk lejon që në procedurën e kuotimit të çmimit të realizohen punë ndërtimore, sipas po të njëjtit ligj parashihet që autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat për kuotimin e çmimeve për të ushtruar një aktivitet të prokurimit që ka për qëllim dhënien e një kontrate të punëve, furnizimeve ose shërbimeve me vlerë minimale ose të vogël në rast të kontratave për punë përfshinë vetëm riparime apo mirëmbajtje.

Për më tepër, Agjencia ka vërejtur se Autoriteti nuk ka përgatitur projektin ekzekutiv të punëve të cilat kanë për t'u realizuar me aktivitetin e prokurimit i cili është në procedurë. Specifikat teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Komuna e Dragashit në këtë rast është përgjegjëse për hartimin e projekteve ekzekutive për gjitha aktivitetet e publikuara të cilët në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjiten specifikave teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni vlerësues

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, komisioni vlerësues ka konstatuar se për këtë kontratë kanë ofertuar tre Operator ekonomik, ku sipas komisionit vlerësues të gjithë Operatorët kanë ofruar tender të përgjegjshëm. AKK pasi ka analizuar letrën standarde për tenderuesit e eliminuar dhe raportin e vlerësimit të tenderëve ka konstatuar se shumica e rubrikave të këtij raporti nuk janë plotësuar dhe si të tilla kanë mbetur të zbrazëta.

Në letrën standarde për tenderuesit e eliminuar komisioni vlerësues i'u ka drejtuar 2 Operatorëve tjerë ekonomik në këtë letër theksohet se komisioni vlerësues, pasi ka kontrolluar dokumentacionin e këtyre Operatorëve ka konstatuar se'' Drejtoria e urbanizmit operatorit ekonomik Shabanaj i ka lëshuar referencat me datë 30.03.2016 ku vlera e përgjithshme e referencave kapë vlerën prej 63,119,87 euro. Prandaj sipas kriterit çmimi me i ulët ky Operator posedon komplet dokumentacionin e kërkuar dhe është fitues i tenderit.

Agjencia pasi ka analizuar me kujdes ofertat veç e veç ka konstatuar se OE Shabanaj i cili është rekomanduar për këtë kontratë nuk është i përgjegjshëm, pasi që tek pjesa C pika 3 e formularit të dorëzimit të kutotimit të çmimit ku është kërkuar që ky kuotim duhet të jet i vlefshëm për një periudhë prej 60 ditëve nga data përfundimtare e dorëzimit të kuotimit të çmimeve i njëjti Operator nuk ka ofruar validitet tenderi. Sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, **Operatorët ekonomik të cilët nuk ofrojnë validitet të tenderit konsiderohen sikur të mos dorëzonin fare tenderi dhe si të tillë duhet të refuzohen si të pa përgjegjshëm.**

Agjencia pasi ka analizuar edhe dy ofertat tjera konstaton se asnjëra prej tyre nuk janë të përgjegjshme, pasi që nuk i kanë plotësuar kërkesat konform dosjes së tenderit më saktësisht njëri Operator ekonomik nuk ofruar validitet tenderi në pjesën 3 të FDT-së ku është kërkuar nga Operatorët të ofrojnë validitet, mungon validiteti është e pa plotësuar. Në rubrikën III.4 tek kërkesat mbi mundësitë teknike ose profesionale ku është kërkuar një Menaxher i projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose arkitekturës. lidhur me këtë kërkesë OE në fjalë ka ofruar diplomë me titull Baçelor i ndërtimtarisë drejtimi hidro-teknik e jo me titull. Si i tillë sipas AKK-së është i pa përgjegjshëm, pasi që nuk i ka plotësuar kërkesat konform dosjes së tenderit.

Ndërsa tjetri Operatori ekonomik i cili sipas komisionit është është shpallur si i përgjegjshëm, sipas AKK-së nuk është i përgjegjshëm, pasi që nuk ka plotësuar kërkesën ku është kërkuar validiteti i tenderit (vlefshmëria e tenderit) prej 60 ditëve, OE në fjalë ka ofruar validitet prej vetëm 30 ditëve. Pastaj nuk ka plotësuar siç duhet FDT tek data e dorëzimit të tenderit ku e ka bërë me datë **06.04.20**. Në FDT gjithashtu mungojnë të dhënat e identifikimit të Operatorit ekonomik tek seksioni II përshkrimi i çmimit.

Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se asnjëri nga Operatorët ekonomik nuk kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm, andaj si të tillë do të duhej të eliminoheshin si të pa përgjegjshëm duke bërë anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit në mungesë të tenderëve të përgjegjshëm.

Agjencia gjithashtu ka vërejtur se në procesverbalin e hapjes së tenderëve mungojnë çmimet e ofruara nga Operatorët ekonomik. Autoriteti kontraktues këtij procesverbal i'a ka bashkangjitur një listë të çmimeve për njësi që kanë ofertuar Operatorët ekonomik. Sipas Legjislacionit në fuqi për prokurimin publik theksohet decidivisht se "Gjatë hapjes së secilit tender, zyrtari i prokurimit do të shpall për ata që janë prezent: (i) emrin dhe vendin e tenderit në fjalë; (ii) çmimin total të tenderit të specifikuar në tender të tillë; dhe (iii) ndonjë koment tjetër apo vërejtje.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e Njoftimit për dhënie të kontratës dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikatat e tilla në të ardhmen.

Veprimet e autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 18 Llogaritja e vlerës së parashikuar të kontratës së punëve, nenin 27 dosja e tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike si dhe nenin 36 Procedurat për kuotimin e çmimeve të ligjit për prokurimin publik Nr.04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237 dhe ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 28 validiteti i tenderit të udhëzuesit operativ për prokurimin publik.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

